



Bazuar në nenin 35 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), në pajtim me nenin 4 paragrafi 3 dhe nenin 14 paragrafi 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 31 gusht 2017 miratoi si në vijim:

RREGULLORE PËR HAPJEN DHE MBYLLJEN BRENDË DHE JASHTË KOSOVËS TË DEGËVE DHE SUBJEKTEVE TË VARURA TË SIGURUESVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për hapjen dhe mbylljen e degëve të siguruesve brenda Republikës së Kosovës dhe hapjen e degëve të siguruesve apo subjekteve të varura jashtë Republikës së Kosovës.
2. Kjo Rregullore aplikohet për të gjithë siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm të licencuar nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës, me përjashtim të nenit 5 i cili nuk është i aplikueshëm për degët e siguruesve të jashtëm.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet si dhe përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
 - 1.1.**Degë** - nënkupton një vend të veprimtarisë afariste të siguruesit i cili formon një degë ligjërish të varur të pa themeluar me vete, nëpërmjet të cilës siguruesi angazhohet në veprimtari siguruese, përfshirë funksione tjera menaxhuese dhe administrative;
 - 1.2.**Zyrë** – nënkupton një vend të veprimtarisë afariste e pa themeluar me vete, e cila i përgjigjet degës së siguruesit, nëpërmjet të cilës siguruesi angazhohet në veprimtari të sigurimeve;
 - 1.3.**Subjekt i varur** - nënkupton personin juridik të veçantë, i themeluar nga siguruesi ose personi juridik që është nën kontroll të përbashkët me siguruesin.

Neni 3

Hapja dhe/ose zhvendosja e degëve të siguruesve brenda vendit

1. Siguruesi i cili vendos të themelojë ose të zhvendosë një degë ose zyre të tij, përfshirë zhvendosjen e zyrës qendrore, duhet të dorëzojë një kërkesë në BQK dhe të marrë miratimin paraprak. Gjithashtu, kërkohet një përshkrim i veprimtarive të planifikuara të degës ose zyrës.
2. Në rastet e zhvendosjes së degës ose zyrës, siguruesi, duhet të njoftojë paraprakisht klientët e asaj dege ose zyre për zhvendosje të saj si dhe lokacionin e ri, duke shpallë njoftimin në mënyrë të dukshme në lokalet e degës ose zyrës, së paku tridhjetë (30) ditë para datës së propozuar të zhvendosjes.
3. Kërkesën për miratimin e hapjes/ zhvendosjes së degës ose zyrës brenda vendit, siguruesi duhet të dorëzojë me shkrim në BQK së bashku me informatat e mëposhtme:
 - 3.1 vendimin e organit vendimmarrës për hapjen/zhvendosjen e zyrës;
 - 3.2 përshkrimin e arsyeshmërisë së hapjes/zhvendosjes të degës;
 - 3.3 marrëveshjen/kontratën e qirasë ose ndonjë dokument tjetër në bazë të së cilës siguruesi ka të drejtë të përdorë ambientet ku dega/zyra do të kryej veprimtarinë e saj;
 - 3.4 adresën e saktë të degës/zyrës së re; dhe
 - 3.5 njoftimin me shkrim për plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për kryerjen e veprimtarisë siguruese. Në këtë njoftim duhet specifikuar hapat e ndërmarra lidhur me plotësimin e këtyre kushteve si dhe fotografitë që dëshmojnë një gjë të tillë;
 - 3.6 dëshminë e pagesë së tarifës;
 - 3.7 informacione tjera shtesë të cilat mund të konsiderohen si të duhura nga BQK-ja.
4. Hapësira ku do të zhvillojë veprimtarinë dega/zyra e siguruesit duhet të jetë së paku pesëmbëdhjetë (15) metra katror (m^2).
5. BQK-ja mund të kryej ekzaminim në degët/zyrat e siguruesve ku planifikohet të ushtrohet veprimtaria, para ose pas miratimit.
6. Pas shqyrtimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës, BQK-ja vendos për miratimin apo refuzimin e kërkesës brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar.
7. BQK-ja ka të drejtë të pezullojë ushtrimin e veprimtarisë së degës/zyrës, nëse ajo konstaton se kushtet teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë financiare nuk janë përmbushur.
8. BQK-ja mund të jap aprovimin edhe para kryerjes së ekzaminimit në lidhje me plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë Rregullore. Megjithatë, pas kryerjes së ekzaminimit, BQK-ja ka të drejtë të pezullojë ushtrimin e veprimtarisë së degës/zyrës, nëse ajo konstaton se kushtet teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë, nuk janë

përmbushur. Në raste të tilla, përveç pezullimit për ushtrimin e veprimtarisë së degës, BQK-ja do të ndërmarr edhe masa të tjera ndëshkuese ndaj siguruesit, të parapara sipas legjislacionit në fuqi.

9. Gjatë procesit të vendosjes për të aprovuar apo refuzuar kërkesën e siguruesit për hapje të degës/ zyre së re apo zhvendosjes së tyre, BQK-së do të marr parasysht:
 - 9.1 ndikimin e hapjes apo zhvendosjes në komunitetin në të cilin dega/zyra do të zhvilloj veprimtarinë;
 - 9.2 gjendjen financiare e siguruesit dhe ndikimin që mund ta ketë hapja /zhvendosja e degës/zyrës, si dhe çdo masë detyruese ekzistuese ose në të kaluarën ndaj siguruesit;
 - 9.3 çdo rrethanë tjetër që e vlerëson të arsyeshme, në funksion të zbatimit të përgjegjësive të saj sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Miratimi për mbylljen e degëve/zyrave të siguruesve brenda vendit

1. Siguruesi duhet të bëjë kërkesë në BQK për miratimin e mbylljes së degës /zyrës, së paku tridhjetë (30) ditë para datës së propozuar të mbylljes.
2. Kërkesa për mbyllje të degës ose zyrës duhet të përfshijë si më poshtë:
 - 2.1. identifikimin e degës/zyrës që do të mbyllet;
 - 2.2. datën e propozuar të mbylljes; dhe
 - 2.3. raportin ku shpjegohen arsyet e marrjes së vendimit për mbylljen.
3. Çdo sigurues që propozon mbylljen e një dege/zyre kërkohet që të shpallë njoftimin për klientët e degës në mënyrë të dukshme në lokalet e degës së paku tridhjetë (30) ditë para datës së propozuar të mbylljes. Në njoftim duhet të theksohet data e propozuar e mbylljes dhe të njoftohen klientët, se ku mund të shërbehen pas datës së mbylljes ose të sigurohen numra telefonikë për klientët, që të mund të kontaktojnë për informata.

Neni 5

Hapja e degëve/subjekteve të varura të siguruesve jashtë Republikës së Kosovës

1. Në mënyrë që të hapin një degë jashtë Republikës së Kosovës, siguruesit duhet të dorëzojnë kërkesë me shkrim në BQK të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 1.1. vendimin e organit vendimmarrës të siguruesit për miratimin e këtij zgjerimi jashtë Republikës së Kosovës;
 - 1.2. vendndodhjen dhe zonën e ushtrimit të veprimtarisë nga dega propozuar;
 - 1.3. një kopje të rregullave dhe procedurave të degës së propozuar, ku përcaktohen veprimtaritë që do të kryhen;
 - 1.4. biznes-planin për degën për tri (3) vitet e para të veprimtarisë;
 - 1.5. shumën e kapitalit që do të investohet jashtë vendit, si dhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës si dhe shpenzimet e tjera operative;

- 1.6.informacionin për personin/at e propozuar si drejtues të degës, të shoqëruar me një përshkrim të shkurtër të kompetencave të tij;
 - 1.7.parashikimin e siguruesit, të rezultatit financiar të saj pas realizimit të këtij zgjerimi, si dhe ndikimin e tij në gjendjen financiare të siguruesit;
 - 1.8.strukturën organizative të degës së bashku me numrin e punonjësve të propozuar;
 - 1.9.emërtimin, e propozuar për t'u përdorur nga dega, që duhet të korrespondojë me emërtimin e siguruesit;
 - 1.10. informata të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme nga BQK-ja.
2. Për të hapur një subjekt të varur jashtë Republikës së Kosovës, siguruesi duhet të dorëzojë një kërkesë me shkrim në BQK të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 2.1.dokumentacioni që kërkohet me paragrafin 1 të këtij neni;
 - 2.2.plani i biznesit i subjektit të varur dhe parashikimi për ndikimin e zgjerimit të rrjetit në gjendjen financiare të siguruesit, për tre (3) vitet e para të veprimtarisë;
 - 2.3.informacion për bordin e drejtoreve dhe menaxherët e lartë të subjektit të varur;
 - 2.4.informacion për identitetin, vendqëndrimin/rezidencën ose selinë si dhe të dhënat tregtare të vitit të fundit për çdo person që do të zotërojë pjesëmarrje influencuese në subjektin e varur;
 - 2.5.veprimtaritë siguroese që subjekti i varur parashikon të kryejë.
 3. Gjatë procesit të vendosjes për të aprovuar apo refuzuar kërkesën e siguruesit për hapje të degës ose subjektit të varur jashtë Republikës së Kosovës, BQK-së do të merr parasysh:
 - 3.1.gjendjen financiare e siguruesit dhe ndikimin që mund ta ketë hapja e degës ose subjektit të varur jashtë Republikës së Kosovës, si dhe çdo masë detyruese ekzistuese ose në të kaluarën ndaj siguruesit.
 - 3.2. çdo rrethanë tjetër që e vlerëson të arsyeshme, në funksion të zbatimit të përgjegjësive të saj sipas legjislacionit në fuqi.
 4. Degët e siguruesve që hapen jashtë territorit të Republikës së Kosovës mund të kryejnë vetëm ato veprimtari, për të cilat siguruesi është i licencuar në Kosovë;
 5. Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike prej datës së pranimit të aplikacionit të kompletuar për degë ose subjekt të varur, BQK-ja duhet të aprovojë ose të refuzojë kërkesën.
 6. Ky nen nuk aplikohet për degët e siguruesve të jashtëm të licencuar në Kosovë.

Neni 6

Masat administrative

Çdo shkelje e kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave nga Neni 124, 125 dhe 126 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet.

Neni 7
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen dispozitat e rregulloreve dhe akteve tjera të lëshuara nga BQK-ja lidhur me hapjen dhe mbyllje brenda dhe jashtë Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura të siguruesve.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci